



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 11574 Prot.

Lezhë, më 24.06.2025

URDHËR

Nr. 328 Datë 24.06.2025

“PËR KALIMIN NË GADISHMËRI TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMEVE, PËR SEZONIN TURISTIK DHE PAGESËN E DITËVE TË SHTUNA DHE TË DIELA”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.1 gërma “b” të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenit 88, neni 89, neni 90 dhe neni 91, ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-së nr.568 datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, shkresës 8793 prot., datë 09.06.2025, të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, në Bashkinë Lezhë, me lëndë “Kërkesë për pagesën e orëve shtesë për punonjësit e mirëmbajtjes së rrugëve, shërbimeve publike dhe pastrimit të plazhit dhe insitucioneve arsimore”, shkresës nr.779 prot., datë 11.06.2025, protokolluar nga ana jonë me nr. 10551 prot., datë 16.06.2025, me lëndë “Informacion për vlerësim të mëtejshëm”, të Njesisë Administrative Shëngjin, shkresën nr. 860 prot., datë 23.06.2025, protokolluar nga ana jonë me nr. 11433 prot., datë 23.06.2025, me lëndë “Informacion për vlerësim të mëtejshëm”, të Njesisë Administrative Shëngjin, shkresës nr.11341 prot., datë 20.06.2025, me lëndë “Informacion për vlerësim të mëtejshëm”, të Policisë Bashkiake, shkresës nr.11375 prot., datë 23.06.2025, të Njesisë Administrative Shënkoll, me lëndë “Kërkesë”, shkresës nr. 11406 prot., datë 23.06.2025, me lëndë: “Informacion për vlerësim të mëtejshëm”, të Njesisë Administrative Shënkoll, shkresën nr. 11406 prot., datë 23.06.2025 të Njesisë Administrative Shënkoll dhe Drejtorisë së Turizmit, me lëndë “Kërkesë”, shkresën nr.11405 prot., datë 23.06.2025, me lëndë “Kërkesë për punonjësit sezonal”, të Drejtorisë së Turizmit, në Bashkinë Lezhë,

URDHËROJ:

1. Kalimin në gatishmëri për sezonin turistik, nga data 10.06.2025 deri me datë 10.09.2025, punonjësve të Shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit

- dhe Mjedisit, të Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës, të Njesisë Administrative Shëngjin, Njesisë Administrative Shënkoll dhe punonjësve të Policisë Bashkiake, në Bashkinë Lezhë.
2. Pagesa do të bëhet për punonjësit, për ditët e shtuna dhe të diela, festat zyrtare, sipas lidhjes nr.1, bashkëlidhur urdhërit si dhe listëprezencës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, Drejtorisë së Turizmit dhe Kulturës, Njesisë Administrative Shëngjin, Njesisë Administrative Shënkoll dhe Policisë Bashkiake, në Bashkinë Lezhë.
 3. Orët shtesë t'iu paguhen në masën 50 % (përqind) shtesë mbi pagën.
 4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Finacës dhe Buxhetit, në Bashkinë Lezhë.
 5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Pjerin Ndreu

